

Data 24.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rehabilitim Shëtitorës Taululantia (loti III)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodi CPV 45233120-6-Punime ndërtimi per rruge**

VLERA E FONDIT LIMIT: 16’956’401 (gjashtëmbëdhjetë milion e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e katerqind e nje) lekë, **pa tvsh.**

Argumentim:

“Rehabilitimi Shëtitorës Taulantia (Loti III)”

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr.277 datë 15.09.2023 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

Dokumentave sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondit limit,

Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës.

PERLLOGARITJA E VLERES LIMIT TE KONTRATES

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmime botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga

autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në: projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit: “Rehabilitimi Shëtitores Taulantia (Loti III)”

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull:
“Rehabilitimi Shëtitores Taulantia (Loti III)”

rezultoi të jetë 16 956 401 **lekë neto pa tvsh.**

Afati i realizimit të punimeve është 42 dite pune.

Garancia për mbulimin të difekteve ,që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jete 2 vjet .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 16'000'000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshetet ne në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",neni 43,b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 32’000’000 lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

NP. 1-A Punime gërmimi në tokë;

NP. 4-A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;

NP. 8-A Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.

NP.11-A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve,

N.S-18 A Punime topogjeodezike;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE	VLERAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP. 1-A	Punime gërmimi në tokë;	<p>3.89/b+3.158/5a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet ne zonen e shtrimit me kubik guri +transport deri 5km</p> <p>3.89/b+3.158/5a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet ne zonen e gjelberimit deri ne 30cm +transport deri 5km</p>	A, 0-20 milionë lekë	124.384 LEKE

NP. 4-A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;	<p>An 164/1b Mbushje me cakull e gur gurore dhe ngjeshur me makineri</p> <p>3,211 "Shtrese çakulli trashësi minimale mbas ngjeshjes 20 cm perhapur e ngjeshur me makineri"</p> <p>3.212/b "Shtrese stabilizant, trashësi minimale mbas ngjeshjes 10 cm</p> <p>"</p> <p>2.262/4 Shtresë betoni C16/20 e armuar me zgare hekuri Ø 6 (20x20), trashësia e betonit 10 - 15 cm nen shtresen e zones se shtruar me kubik guri</p> <p>2,166 F.V hekur ne shtresat me beton nen shtresen e zones se shtruar me kubik guri (zgare 20x20) Ø6</p> <p>An F.v shtrim me kubik gur gri/bardhe te vendit permasa 15x15 cm trashesi 8-10 cm, fuge max 1 cm</p> <p>An F.v bordure prej guri i bardhe me qoshe te latuar, permasa 15x25 dhe 15x35 cm</p> <p>2.262/3 Shtresë betoni C12/15 per nivelim bordure</p>	A, 0-20 milionë lekë	10.101.379 leke

		<p>An Beton C 20/25 i trajtuar me aditiv kunder kriprave te ujit te detit per traun 50x30 te themelit</p> <p>An Beton C 20/25 i trajtuar me aditiv kunder kriprave te ujit te detit per themelin</p> <p>2,167 FV. Hekur per traun e themelit</p> <p>An Mbushje me dhe vegjetal</p> <p>3,643 Mbjellje me bari</p> <p>An F.v peme LIGUSTRUM JAPONICUM diametri. 14/16 cm (ligustro)</p> <p>An F.v kosha mbeturinash</p> <p>4,3 Konstruksione metalike dekorative per kangjellat e pemeve tek rruga hotel Arvi</p> <p>An F.V pomp vaditje 18.5 kw</p>		
NP. 8-A	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.	An Mbushje me gure 1.5÷2.5. ton sipas projektit platforma me gure qe sherbejne per zgjerimin e shetitores.	A, 0-20 milionë lekë	3 000 000 leke
N.P.11-A	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit	AN1 F.V. Ndriculesi tip A2PL2 ka shtyll ndricimi me H=6ml mbi toke me dy ndricues, njeri i montuar ne lartesine 6ml	A, 0-20 milionë lekë	2.719.152 leke

	<p>linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike</p>	<p>dhe karakteristika teknike jo me te vogla se 58w dhe fluks 5960lm, ndersa ndricuesi tjetër i montuar ne lartesine 4 ml dhe me karakteristika teknike jo me te vogla se 33w dhe fluks 3160lm IK 08 IP 66 dhe jetegjatesi jo me pak se 100000ore pune (shiko specifikimet teknike)</p> <p>AN2 F.V. Ndricuesi tip A1PL1 ka shtyll ndricimi me H=6ml mbi toke me nje ndricues, i montuar ne lartesine 6ml dhe karakteristika teknike jo me te vogla se 58w dhe fluks 5960lm, IK 08 IP 66 dhe jetegjatesi jo me pak se 100000ore pune (shiko specifikimet teknike)</p> <p>3An/pp F.V. Puseta plastike 40x40x40 me kapak te forte RIC 1084 +1086</p> <p>3,654/2 F.V. tub plastik fleksibel D=80 me dy veshje</p> <p>4.141/a7.0 F.V. shirit sinjalizimi per kabllot e ndricimit</p> <p>An.3 F.V.Kabell cu FROR 5 x 6mm² ,tokezimi me neuter te perseritur.</p> <p>A 4,134/3.2 F.V.Kabell I TU 3 x 2.5mm²</p> <p>3.An/etFV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm</p>		
--	--	--	--	--

		3,45/1 Germim kanali ne tok te zakonshme,me krah,per shtrirje tubi elekt. 2,262/4 Mbushje me beton te shtyllat 2,261 Mbushje me rere 2,522 Tub kanalizimi pvc Ø170mm per shtyllat		
NS-1 A-	Punime per prishjen e ndertimeve	2.426/3 Prishje shtrese betoni 3.25/b Prishje trotuareve + germim 3,3 Heqje peme ekzistuese An Heqje bordure betoni	A, 0-20 milionë lekë	217.610 leke
N.S.18- A	Punime topogjeodezike;	Është kërkuar për arësye të zbatimit të rilevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)

Për stafin e sipërcituar të paraqese dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve dhe kontrata pune.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a.Inxhinier Elektrik	1 (nje)
b.Inxhinier Gjedoet	1 (nje)
c.Teknik ndertimi	1 (nje)

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: Dëshmi profesionale e teknikut te ndertimit ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

• Manovratorë	1 punonjes
• Drejtues Mjeti	2 punonjes
• Elektracist	2 punonjes
• Hekurthyes	2 punonjes
• Karpentier	2 punonjes
• Punëtoare ndertimi te thjeshte	15 punonjes

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

.....

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit

stabiliznatit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll, stabilizant binder dhe asfalt.

- **Inxhinieri gjeodet** është kërkuar me qëllim realizimin e rievimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit.
- **Inxhinieri i Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit elektrik për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin punimeve elektrike.
- **Tekniku i Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë punimeve ndërtimore ne baze të zërave te preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike te zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.
- **Manovratorët** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda si eskavatori, rruli, graideri,
- **Drejtuesit** e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere
- **Hekurthyesit dhe karpentieret** duhen per realizimin në vend të strukturave beton arme sipas projektit
- **Elektracistët** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike.
-

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre)

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 28 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri prej 28 punonjës përfshin 15 punëtorë të thjeshtë + personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, murator, hekurkthyes, karpentier të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu per llogaritjen e numrit te punonjesve jane marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton	1 copë

Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton	1 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton	1 copë
Eskavator me goma	1 copë
Autobetoniere	1 copë
Autobot Uje	1 copë
Rul me vibrim	1 copë

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Çertifikata e Transportit të mallrave/Liçenca, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumetimi:

Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punes se mjeteve .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe

Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

Certifikat: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- Certifikat: ISO 45001:2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.3. 8 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK "Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**"

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Punë

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit REF-85173-10-24-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rehabilitim Shëtitores Taululantia (loti III)

5.Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 45233120-6
Punime ndërtimi per rruge

6. Fondi limit: 16’956’401 (gjashtëmbëdhjet milion e nentëqind e pesëdhjet e gjashtë mijë e katërqind e një) lekë pa tvsh.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:42 (ditë)

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 09.11.2023 Ora 10.00

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njesisë së prokurimit, pas miratimit te gjithë anetaret e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit